

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kushtetuesja vuri në pikëpyetje proporcionalitetin e arrestit, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun E rion Veliaj
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/gjykata-e-larte-merr-vendimin-per-veliajn-kryebashkia-ku-mbetet-ne-burg-i586202
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:16:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	61ad803718df77c1ab715958db43715ffa1507a0e3995cfa99f0627d6297993b
TEKSTI	8ceb6a085185ee749f6e79205ee1d21d8c8023289e332ca1af37f28f8706f8b9
PAMJA	a119056a39796191439bfa3c3c5f5005d56c8adc61499d3d3aae39d433313eb3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f7b02a2d08b8647e14d5ea6c78abb9f100d53251584de59bd1d4a248aef4d792
E MËPARSHMJA	f22fc0ce4cbbc85bf43330b7be7c9362fd55827932dbfb40e7bfeb136c8e9d8d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f7b02a2d08b8647e14d5ea6c78abb9f100d53251584de59bd1d4a248aef4d792>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Vijon kriza politike ne Kosove/ PDK-ja con ne Kushtetuese edhe formimin e QeveriseS' eshte puna se duan 10 mije euro, por se sillen si pronare te shtetit](#)[Depistimi i femije fundit](#)

Kushtetuesja vuri në pikëpyetje proporcionalitetin e arrestit, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun Erion Veliaj



15 Shtator 2026, 11:12Kronika TEMA



Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën e Erion Veliajt për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, duke lënë në fuqi masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur këtë të martë, në Dhomë Këshillimi, shqyrtoi kërkesën e Erion Veliajt kundër vendimeve të mëparshme të gjykatave të posaçme.

Veliaj kërkonte shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe një vendimi të mëparshëm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me masën e sigurisë ndaj tij.

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 13, datë 13 mars 2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Vendimi është marrë bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Penale.

Me këtë vendim, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën e Veliajt dhe ka lënë në fuqi vendimin e Apelit të Posaçëm, duke bërë që kryebashkiaku i Tiranës të vijojë të qëndrojë në burg.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur në datë 15 shtator 2026, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim dosjen penale me palë: Kërkues: Erion Veliaj, Palë e Interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe objekt: Shfuqizimin e vendimeve nr. 7, dt. 09.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlefesuar përmes vendimit nr. 14, dt. 12.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, dt. 13.03.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), dt. 08.07.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

Pasi shqyrtoi çështjen, Kolegji, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Penale, vendosi: Lënien në fuqi të Vendimit nr.13 (87-2025-85), datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Cënuan perimetrin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë](#)

10:55 Kronika

[Himarë/ Ndezi disa vatra zjarri në kullota e pyje, kapet në flagrancë 52-vjeçari \(VIDEO\)](#)

10:35 Kronika

Nga arratisjet spektakolare te dënimet me burgim të përjetshëm, si arriti Alket Rizai të merrte 16 leje për të dalë nga qelia

10:05 Kronika

Dosja “Revanshi”, GJKKO jep vendimin për 7 të pandehurit, mes tyre Durim Bami

09:45 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.